



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DURRËS
DREJTORIA LIGJORE**

PROJEKTVENDIM

NR. _____, DATË ___/___/2026

**PËR MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR BARAZI GJINORE 2026 –
2030 NË BASHKINË DURRËS**

Mbështetur në Ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin nr. 64/2025, datë 6.11.2025 “Për barazinë gjinore”, Ligjin 57/2019 10.03.2005 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin Nr.121, datë 24.11.2016, “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës nr. 73, datë 23.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2026 dhe programin buxhetor afatmesëm 2026-2028”, Planin Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2023-2025, Urdhërit të Kryetares së Bashkisë nr. 126, datë 08.04.2026 “Për ngritjen dhe funksionimin e Komisionit të Barazisë Gjinore në Bashkinë Durrës”, në kuadër të angazhimeve të ndërmarra përmes nënshkrimit të Kartës Evropiane për Barazi të grave dhe burrave në jetën vendore, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimit Social dhe Komisioni i Barazisë Gjinore në Bashkinë Durrës, Kryetarja e Bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak të shqyrtojë në përputhje me aktet ligjore dhe,

TË VENDOSË:

1. Miratimin e Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ) 2026 – 2030, bashkëngjitur këtij projektvendimi, të përgatitur nga Bashkia Durrës si mjet kryesor për zbatimin e angazhimeve publike për barazinë gjinore.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi administrata e Bashkisë Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”.

DREJTORIA LIGJORE

Drejtores

Alneida Rroshi

DREJTORIA SHËRBIMIT SOCIAL

Drejtores

Diola Xhango

DREJTORIA E BUXHETIT

Drejtores

Valbona Qiriako

KRYETARE E BASHKISË

Emiriana Sako